



Data: 18.05.2018

Ref.: 422/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Studimeve Islame për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.556/17, datë: 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr. 556/17, datë: 06.07.2017, për programin e studimit:
 - Teologji Islame, MA, 60 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studentëve në programet e cekura në pikën dy të këtij vendimi.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Studimeve Islame me datë: 07.09.2017, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së, nr.556/17, datë: 06.07.2017, me të cilin vendim Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, i është pezulluar akreditimi për dy programe studimi të cekura në vendimin përkatës.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Fakulteti i Studimeve Islame, është konstatuar që edhe programi i studimeve i cekur më sipër i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë: 20.09.2016, neni 11, pika 3.2. Sipas kësaj pike, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të ketë të paktën tre persona në marrëdhënie të rregullt pune të nivelit PhD për secilin program të studimit.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me datë: 22 Shtator 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Studimeve Islame
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

